

**AKT NORMATIV
Nr.1, datë 9.3.2003**

**PËR VËNIEN NË DISPOZICION TË HAPËSIRËS TOKËSORE, DETARE E AJRORE DHE
DËRGIMIN E NJË FORCE USHTARAKE SHQIPTARE NË RAJONIN E GJIRIT PERSIK,
NË KUADËR TË KOALICIONIT NDËRKOMBËTAR TË LUFTËS KUNDËR
TERRORIZMIT**

Në mbështetje të neneve 2 pika 3, 12 pika 3 dhe 101 të Kushtetutës, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Neni 1

Republika e Shqipërisë vë në dispozicion të forcave të koalicionit ndërkombëtar kundër terrorizmit hapësirën tokësore, detare dhe ajrore, si dhe krijon lehtësira stërvitore.

Neni 2

Pjesëmarrjen me një kompani komando, të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, së bashku me strukturat mbështetëse, në rajonin e Gjirit Persik, në kuadër të koalicionit ndërkombëtar të luftës kundër terrorizmit, si kontribut i Republikës së Shqipërisë në operacionet në mbështetje të paqes.

Neni 3

Këshilli i Ministrave përcakton masën e shpërblimit ditor të ushtarakëve në përbërje të njësisë, si dhe trajtimin dhe përballimin e shpenzimeve për kompensimin e pasojave që rrjedhin për shkak të zbatimit të detyrës.

Neni 4

Ky akt normativ hyn në fuqi menjëherë.

**KRYEMINISTRI
Fatos Nano**